

VENDIM
Nr. 294, datë 24.4.2026

**PËR MIRATIMIN E KOEFICIENTIT TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË
VLERËSUAR TË VITIT 2024, PËR LLOGARITJEN E PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të dytë, të nenit 10, dhe të pikave 1 e 3, të nenit 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2024, me koeficient indeksi 6.4 %, të llogaritur sipas kriterëve të përcaktuara në nenin nr. 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Indeksi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, aplikohet për llogaritjen e bazës së vlerësuar individuale vjetore, të arritur nëpërmjet kontributeve të paguara dhe rivlerësimeve të tyre, të kryera deri në vitin 2024, dhe zbatohet për efekt të llogaritjes së masës fillestare mujore të pensioneve, me datë lindjeje të së drejtës, nga data 1.1.2026 e në vazhdim.

3. Indekset akumulative të bazës së vlerësuar, të arritura nëpërmjet pagave të periudhës 1994–2024, referuar kontributeve të paguara, sipas muajve në këtë periudhë dhe pagave referuese, sipas punëve dhe profesioneve, të përcaktuara me vendimin nr. 561, datë 12.8.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”, të ndryshuar, sipas viteve, janë sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Pas aplikimit të indeksit të vitit 2024, baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së masës fillestare mujore të pensioneve, që do të caktohen me datë lindjeje të së drejtës, nga data 1.1.2026, nuk mund të jetë më e lartë, se:

a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për pagat e periudhës, nga viti 1994 deri në 31.12.2001;

b) paga maksimale në shkallë vendi, e përcaktuar sipas kriterëve të nenit 10, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për pagat e periudhës, nga viti 2002 e në vazhdim.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, lidhen me zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve dhe aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë lindjeje të së drejtës, nga data 1.1.2026 e në vazhdim, dhe përballohen brenda buxhetit vjetor, të miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

6. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

Tabela e koeficientëve akumulativë të indeksimit të bazës së vlerësuar	
Për pagat referuese deri në datën 31.12.1993	14.259
Për pagat e vitit 1994	14.259
Për pagat e vitit 1995	11.474
Për pagat e vitit 1996	8.903
Për pagat e vitit 1997	8.903
Për pagat e vitit 1998	7.440
Për pagat e vitit 1999	6.038
Për pagat e vitit 2000	5.499
Për pagat e vitit 2001	4.704
Për pagat e vitit 2002	4.345
Për pagat e vitit 2003	3.889
Për pagat e vitit 2004	3.532
Për pagat e vitit 2005	3.208
Për pagat e vitit 2006	2.913
Për pagat e vitit 2007	2.784
Për pagat e vitit 2008	2.459
Për pagat e vitit 2009	2.262
Për pagat e vitit 2010	2.165
Për pagat e vitit 2011	2.084
Për pagat e vitit 2012	2.004
Për pagat e vitit 2013	1.921
Për pagat e vitit 2014	1.921
Për pagat e vitit 2015	1.660
Për pagat e vitit 2016	1.660
Për pagat e vitit 2017	1.627
Për pagat e vitit 2018	1.571
Për pagat e vitit 2019	1.534
Për pagat e vitit 2020	1.490
Për pagat e vitit 2021	1.438
Për pagat e vitit 2022	1.321
Për pagat e vitit 2023	1.163
Për pagat e vitit 2024	1.064
Për pagat e vitit 2025	1.000
Për pagat e vitit 2026	1.000